



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 13.10.2008, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Ibrahim Selmanaj-nënkryetar, Berat Luzha, Selvie Halimi, Elheme Hetemi, Zulfi Merxha, Zef Morina, Ali Lajçi, dhe Myrvete Pantina. **Mungoi** : Lulzim Zeneli, dhe Kosara Nikoliq (në mbledhjen tjetër).

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Nga MMPH Nazmi Shkodra etj, nga OSCE Blerim Vela

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Lule Ymeri

Mbledhjen e kryesoi : **Ibrahim Selmanaj**, nënkryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit,**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës,

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje, **njëherit kërkoi që tjera herë mos të përsëriten gabimet teknike sa i përket sallës (mosfunksionimi i aparateve për përkthim).**

2. Shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit

Në fillim **kryesuesi** kishte një kërkesë që komisioni të jap konfirmimin për leximin e dytë për dy projektligje për të cilat kanë ardhur shkresat se janë shqyrtuar nga komisionet kryesore, për projektligjin e Produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe Organizmat e modifikuara gjenetikisht.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Lidhur me projektligjin e PMB dhe OMGJ komisioni funksional nuk ka vërejtje shtesë dhe pajtohet që ato të procedohen më tutje për leximin e dytë.

Lidhur me **projektligjin për Mbrojtjen e Mjedisit** kryesuesi fillimisht kërkoi që nga anëtarët e komisionit të epet konfirmimi se a mund të vazhdoi shqyrtimi i projektligjit në bazë të renditjes së amendamenteve që është bërë nga stafi lidhur me këtë projektligj.

Selvie Halimi në cilësinë e raportueses për këtë projektligj konstatoi se vërejtjet e Blerim Velës (OSCE) plotësisht i përkrah, ndërkaq vërejtjet tjera duhet të shqyrtohen me vëmendje, pasi që thellësisht dallohen (p.sh. disa i japin rëndësi më tepër ministrit sesa ministrisë).

Lidhur me Nenin 1 komisioni miratoi :

Amendamentin 1

- 1. Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.**
- 2. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.**

Amendamenti 2

Neni 2

Shtohen në fund pikat si vijon :

g) Të sigurohet se zhvillimi në Kosovë është i qëndrueshëm në mënyrë që dheu, ajri, uji dhe burimet e jetesës në Kosovë të mbrohen dhe ruhen në të mirë të gjeneratave të ardhshme;

h) Të promovohen masa regjionale dhe ndërkombëtare për ruajtje, mbrojtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit; dhe

i) Të bëhet përshtatja e ligjeve, akteve nënligjore, procedurave dhe institucioneve të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në vazhdim komisioni diskutoi për disa përkufizime tek neni 4 duke u ndalur tek përkufizimi “ndotja e mjedisit”.

Pasi që vërejtjet në fjalë komentohen më gjatë dhe humbet koha, kryesuesi sugjeroi që mbledhja të përfundoi për sot dhe të vazhdoi në bashkëpunim me grupin punues, të cilët do të sugjerojnë komisionit se cilat vërejtje janë më të mira për miratim.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Grupi punues e përbërë nga Selvie Halimi, Haset Cakolli dhe Zef Morina deri në mbledhjen e ardhshme do të shqyrtojnë vërejtjet në fjalë dhe do të sugjerojnë komisionit për miratim ato të cilat i plotësojnë kushtet.

Të ndryshme

Blerim Vela njoftoi se vizita në Hungari do të realizohet më 11 dhe 12 nëntor , ndaj njoftoi anëtarët e komisionit nëse kanë ndonjë pyetje mjedisore (apo lidhur me bujqësi) të përgatisin ato, pasi që në Hungari ekziston Ombudspersoni për çështje mjedisore. Elheme Hetemi u interesua për fondin e zhvillimit rural në çfarë forme ekziston në atë shtet, si agjension apo në një trajtë tjetër.

Me iniciativën e **Berat Luzhës** i cili tha se është koha për të bërë sugjerime për Buxhetin e vitit 2009, komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Komisioni me një shkresë ti drejtohet Qeverisë, përkatësisht MEF për ndarjen e mjeteve shtesë për stimulimin e Bujqësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 14,15

Kryesuesi i Komisionit,
Ibrahim Selmanaj